

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.D. nga .... , për shkak të veprave penale: Rrezikim I trafikut publik, nga neni 297 parag.5 lidhur me paragrafin 5 dhe mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 301 parag. 2 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani, PP.nr.666/11, prej dt.22.03.2011 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datën 23.12.2014, në prezencën e palëve publikisht komunikoi, ndërsa më dt.26.12.2014, përpiloi këtë,

## A K T G J Y K I M

## I a k u z u a r i:

A.D., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për veprë tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

## Ë s h t ë f a j t o r ë

## I

Me datë 28.02.2011, rreth orës 13:20 min, në ...., në lokacionin para supermarketit “...” i pandehuri nga pakujdesia , ka shkelur ligjin mbi trafikun publik duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë, ashtu që duke drejtuar automjetin e tipit Audi, ngjyrë e zezë, me tabela të regj. ...., pronë e të njejtit, i pandehuri pasi del nga supermarketi i lartëcekur, hyn në veturë dhe në momentin e lëvizjes me veturë mbrapa (rikuerc) për të dalë nga parkingu si pasojë e manipulimit të pasigurtë në automjet, godet tani të dëmtuarin M.C. të cilit i shkakton lëndime të rënda trupore si pasojë e goditjes së marrë detyrohet të kërkoj ndihmën mjekësore në Spitalin Regjional të Gjilanit- Reparti i Emergjencës

-me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së.

## II.

Me datën, kohën dhe vendin e cekur si në dispozitivin e parë, i pandehuri pasi ka shkaktuar aksident të trafikut me veturën e tipit Audi, ngjyrë e zezë me tabela regj. .... duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore tani të dëmtuarit M.C., ikë nga vendi I ngjarjes duke mos u ndalur për t’i dhënë ndihmën e nevojshme mjekësore të dëmtuarit edhe pse sipas dispozitave ligjore një gjë e tillë ka pasur për obligim ta bëj

-me çka ka kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik nga neni 301 paragrafi 2 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41,45,73, 75, 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

## E g j y k o n

Për dispozitivin I. të kësaj aktakuze me dënim burgu në kohëzgjatje prej /3/ tre muaj, për dispozitivin II. dënim burgu në kohëzgjatje prej /3/ tre muaj.

Gjykata duku u mbështur në nenin 80 të KPK-së të akuzuarin e gjykon me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej /5/ pesë muajve, të cilin dënim ka për ta vuajtur pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit në afat prej 15 ditëve.

**Konform nenit 62 parag. 2 nënparag. 2.5 të KPRK-së të akzuarit i shqiptohet dënimi plotësues ndalimi I drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej një viti .**

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale , për ekspertizën mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 81.76 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €. krejt këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale nga Gjilani, me akuzën si në hyrje të aktgjykimit ka akuzuar A.D. , për shkak të dy veprave penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 parag. 5 lidhur me parag.3 dhe mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatëkeqësitë e trafikut publik nga neni 301 parag. 2 të KPK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilin përfaqësuesja e akuzës Rozelida Hasani , të akuzuarit ia ka lexuar aktakuzën PP.nr.666/2011 të dt.22.03.2011,

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e Shtetit i akuzuari e ka pranuar fajësin për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzën e prokurorit të shtetit në Gjilan.

Meçë i akuzuari ka pranuar fajësin, gjyqtarja ka vlersuar se janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 pika 1.1,1.2,1.3,dhe 1.4 të KPPRK- së , se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është kontestuar nga i akuzuari se përmban shkelje ligjore apo gabime faktike.

Andaj gjykata nuk zhvilloi prova në shqyrtimin gjyqësor nga se gjendja faktike nuk është kontestuar nga i akuzuari.

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani në fjalën e saj përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kërkon nga gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptoj dënim meritor sipas ligjit, me rastin e caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit i propozon gjykatës që ndaj të akuzuarit të mirren parasysht rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Gjykata është njoftuar përmes një parashtrese nga djali i të dëmtuarit tani i ndjer se prindi M.C. nga .... është i vdekur më dt. 29.08.2011.

I akuzuari A.D. në fjalën e tij përfundimtare ka pranuar fajësinë, është penduar thell për veprën penale të shkaktuara, premtan se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshum gjatë vozitjes, ka qenë i moshës së re është friguar në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë i hutuar, ka ftuar ambulancën por nga friga nuk i ka dhenë ndihmë, është penduar thellë, është i gjendjes së vështirë ekonomike, andaj lut gjykatën t'i shqipton një dënim sa më të butë konform ligjit.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësin e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 74 të KPRK –së ndikojn që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rënd, ashtu që gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori: pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte të tij në gjykatore, pendimin, premtimi se nuk do të ndeshet më asnjëher me ligjin, gjendjen jo të mirë ekonomike, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së vepërve penale, bashkëpunues me gjykatën, nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale, mosdhënjënen e ndihmës personit të lënduar, dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, andaj gjykata konsideroi se edhe dënimi i shqiptuar prej 5 muajëve me burg efektiv do të arrijë te i akuzuari qëllimin e dënimit, i parashikuar sipas dispozitave ligjore nga neni 4 , 41, 74, 75, 76 të KPRK-së,nga se qëllimi i dënimit është që kryerësin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëjë risocializimin e tij, andaj bazueshëm mund të pritët që dënimi i shqiptuar do të ndikoj pozitivisht në përmirsimin e të akuzuarit dhe do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPRK-së.

Gjykata nga të cekurat si më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE KAMENICE-**

Më datën 26.12.2014. P.194/2011

Procesmbajtësja  
Emine Zubaku,d.v.

Gj y q t a r j a  
Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej  
15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së  
Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.